



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 4
Prishtinë, më 9 nëntor 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-1-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Verica Çaraniq, Faton Topalli, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Albert Kinolli, Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Ali Lajçi dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Blerim Kuçi.

Stafi mbështetës i komisionit: Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Mentor Hyseni-GIZ; Kosum Aliu-MF; Fatmi Gashi-MF; Kimete Arifi-MF dhe Gramoz Paqarada-KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më datë 17.10.2017 dhe 19.10.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi që miratohet rendi i ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë 17.10.2017 dhe 19.10.2017

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 17.10.2017 dhe 19.10.2017, u miratuan pa vërejtjeje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016

Kryetari, paraqiti para deputetëve raportin vjetor për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016. Në bazë të nenit 6 paragrafi 6.2, pika (h) të LMFP, dhe në bazë të nenit 8, pika 1.2 e Ligjit për auditimin e brendshëm, drejtori i NJQHAB-së, duhet të përgatisë dhe të dorëzojë në ministri, raportin vjetor formal me shkrim, për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm, i cili raport pastaj, së bashku me komentet e ministrit, procedohet në Qeveri, Kuvend dhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit. Raporti paraqet të arriturat, gjetjet, sfidat dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik. Fokusi im është në veprimet që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për adresimin e rekomandimeve të dala nga shqyrtimi i raportit të vitit të kaluar. Me qëllim që auditimi i brendshëm nëpër organizata buxhetore të jetë më efektiv, Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm, duhet të bëjë monitorimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe të kërkojë që njësitë e auditimit të brendshëm, nëpër organizata buxhetore, të bëjnë një planifikim të arsyeshëm të aktiviteteve vjetore, ku përfshihet numër më i madh i auditimeve. Gjithashtu, gjatë vitit 2016 është bërë edhe monitorimi i disa njësive të auditimit dhe janë dhënë rekomandime për përmirësim. Kjo ka ndikuar që gjatë vitit 2016, krahasuar me vitin 2015, të kemi rritje të auditimeve të kryera, përkundër që mbi 50% e auditorëve të brendshëm ishin në proces të certifikimit. Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në mes të auditimit të brendshëm dhe menaxhmentit, Njësia qendrore harmonizuese për auditim të brendshëm të planifikojë tryeza diskutimi, nëse është nevoja edhe trajnime për menaxhmentin, në mënyrë që të kuptohet drejt funksioni dhe roli i auditimit të brendshëm. Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në mes të auditimit të brendshëm dhe menaxhmentit, Njësia Qendrore Harmonizuese ka organizuar konferencën për kontrollin e brendshëm të financave publike për menaxhmentin e lartë, zyrtarët financiarë, auditorët e brendshëm dhe shoqërinë civile.

Thënë në përgjithësi, KMFP ka dhënë 7 rekomandime me rastin e shqyrtimit të raportit për vitin e kaluar, dhe nga këto rekomandime, një pjesë e tyre është adresuar në tërësi dhe pjesa tjetër është në proces të adresimit. Me këtë hapi diskutimin.

Fatmir Gashi, theksoi se Ministria e Financave ka përgatitur raportin në fjalë, përmes së cilit ka pasqyruar gjendjen reale të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Kosum Aliu, paraqiti para deputetëve raportin vjetor të auditimit për vitin 2016, duke theksuar se është bërë progres në adresimin e çështjeve të vlerësuara, si jo mirë të organizuara dhe të zbatuara, duke përmendur se NJQHAB për këtë ka përgatitur edhe planin e veprimit dhe të njëjtin ka dorëzuar në KMFP. Raporti përmbledh vetëvlerësimin e bërë nga zyrtarët kryesorë

administrativ dhe zyrtarët kryesorë financiarë të organizatave buxhetore dhe të auditorëve të brendshëm lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, e kombinuar me gjetjet e NJQHAB-së gjatë procesit të monitorimit, Raporti i Progresit. Gjithashtu, raporti jep informacione rreth aktivitetit të Njesisë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm për vitin 2016. Nga 108 organizata buxhetore, të cilat kanë pranuar formularët e vetëvlerësimit, 100 prej tyre kanë plotësuar pyetësorët apo shprehur në përqindje 93% e tyre. Po ashtu, është vërejtur se ka përmirësim në cilësinë e plotësimit të formularëve. (Kjo është arritur përmes trajnimeve të organizuar nga NJQHAB). NJQHAB ka arritur progres në fushën e auditimit të brendshëm, si në ngritjen e kapaciteteve të auditorëve, po ashtu edhe në licencimin e një numri prej 52 auditorëve të brendshëm të rinj, si dhe trajnimin e 125 auditorëve që synojnë t'i nënshtrohen programit të certifikimit. Numri i auditorëve të brendshëm të certifikuar është rritur nga 67 që kishte në vitin 2015 në 98 auditorë në vitin 2016 apo shprehur në përqindje, në 46%. Po ashtu, për aktivitetet e zhvilluara në fushën e auditimit të brendshëm, nga 72 njësi të auditimit, kanë raportuar 69 prej tyre apo mbi 95% e tyre.

Faton Topalli, theksoi se ka probleme të mëdha në fushën e auditimit të brendshëm. Sipas raportit, një pjesë e organizatave nuk kanë plotësuar formularët e vetëvlerësimit, një pjesë e organizatave nuk kanë themeluar komitetet e auditimit, si dhe njësitë e auditimit të brendshëm. Sipas tij, këtu problemi nuk është tek auditori i brendshëm, problemi është te menaxhmenti i organizatës, i cili nuk merret me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditori i brendshëm. Më tej, theksoi se askund në raport nuk përmenden veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti për shkelësit e ligjit. Këtu defekti nuk është në mungesë të bazës ligjore, këtu kemi mungesë të vullnetit për zbatim të rekomandimeve të dhëna nga auditori i brendshëm. Pra, thënë shkurt, përgjegjës për shkeljet e konstatuara nga auditori i brendshëm nuk mbetet askush, sepse ne vetëm po konstatojmë gjendjen. Propozoi që këtij raportit t'i bashkëngjitet edhe pyetësi i vetëvlerësimit, si dhe masat e ndërmarra për shkelësit e ligjit.

Zafir Berisha, theksoi se esenca e raportimit të Qeverisë për kontrollin e brendshëm financiar është për të caktuar nivelin e llogaridhënies së auditorit të brendshëm, përbrenda institucionit ku vepron. Problem në vete është se auditori po e konstaton gjendjen, mirëpo menaxhmenti nuk merr veprimet e nevojshme për të ndëshkuar shkelësit e ligjit. Një situatë e ngjashme është edhe me raportet e auditimit të përgatitura nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Nuk ka veprime konkrete në kontest të adresimit të rekomandimeve. Ne, si komision, duhet të japim rekomandime, me qëllim që të ngremë llogaridhënien.

Shqipe Pantina, theksoi se bazuar në të dhënat e paraqitura në këtë raport, shihet se ka progres në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Raporti ka më tepër të dhëna numerike, të cilat janë vështirë të kuptueshme. Sipas saj, raporti është dashur ta ketë pyetësorin e vetëvlerësimit, me qëllim që ta kuptojmë më drejt edhe vetë raportin. Përsëritja e rekomandimeve të njëjta, vit pas viti, nënkupton se nuk ka pasur interesim nga menaxhmenti për të implementuar rekomandimet, por askund në raport nuk ceket se cilat ndëshkime ka ndërmarrë menaxhmenti ndaj zyrtarëve për shkelje të ligjit. Pyeti: këtë vit janë certifikuar një numër i konsideruar i auditorëve të rinj, a ishte kriter që secili auditor i brendshëm duhet ta ketë licencën për ta ushtruar këtë funksion apo kjo është bërë për të rritur numrin e auditorëve të brendshëm? A ekziston ndonjë mekanizëm që i verifikon saktësinë e të dhënave të paraqitura në formularin e vetëvlerësimit?

Albert Kinolli, theksoi se sipas raportit thuhet se ende në disa organizata buxhetore ka ngecje në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit, mirëpo nuk ceket se në cilat organizata. Po ashtu, shtoi se menaxhimi i rrezikut dhe kontrollit në disa OB, nuk është bërë ashtu siç kërkohet me standarde. Cilat ishin veprimet e NJQHAB për t'i ndihmuar OB-të në këtë proces? Po ashtu, shtoi se nëse edhe vitin e kaluar ka pasur rekomandime, të cilat nuk janë adresuar, e prapë të njëjtat po përsëriten vit pas viti, atëherë shtrohet pyetja, cili është roli i NJQHAB për t'iu ndihmuar auditorëve dhe menaxhmentit të OB-ve?

Ali Lajçi, theksoi se roli i auditimit të brendshëm është jetik për institucionet, sepse auditori i brendshëm i ndihmon menaxhmentit në arritjen e objektivave. Auditori i brendshëm ka rolin e këshillëdhënësit në institucione, së bashku me njësitë e auditimit të brendshëm dhe komitetin e auditimit, i ndihmojnë menaxhmentit që institucionet t'i arrijnë objektivat e tyre. Pavarësia e auditorit varet se nga kush emërohet dhe kujt i raporton. Jam ihtar i asaj se duhet t'u jepet pavarësi në veprim auditorëve të brendshëm.

Mërgim Lushtaku, pyeti: sa nga të punësuarit si auditorë të brendshëm në institucione ende nuk kanë licencë, si dhe në kohën kur është bërë rekrutimi i tyre, a ka qenë si kusht që të posedojnë licencë në fushën e auditimit të brendshëm, si kusht për t'iu nënshtruar konkursit? Po ashtu, është mirë që së paku udhëheqësi i njësisë së auditimit ta ketë licencën në fushën e auditimit.

Kosum Aliu, në pika të shkurtra u përgjigj në të gjitha pyetjet e parashtruara.

Andin Hoti, theksoi se meqenëse auditori i brendshëm është shërbyes civil, në mënyrë automatike ai bëhet i varur nga menaxhmenti i tij. Çdo kërkesë e auditorit të brendshëm duhet ta ketë miratimin sekretarit të OB-së. Po ashtu, meqenëse formulari i vetëvlerësimit është i plotësuar nga menaxheri i programit, atëherë nënkuptohet se mund të jetë i mbivlerësuar, por për këtë duhet të ketë mekanizëm për të vlerësuar se sa janë reale të dhënat e prezantuara në këtë formular.

Fatmir Gashi, u përgjigj në shumicën e pyetjeve të deputetëve, të paraqitura në këtë takim.

Kryetari, pasi u mbyll debati për këtë pikë, lexoi rekomandimet e përgatitura nga stafi mbështetës i njësisë: 1. Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), të raportojë në KMFP për masat e ndërmarra ndaj institucioneve që nuk kanë plotësuar formularët e vetëvlerësimit, si dhe të njoftojë komisionin se menaxhmenti i cilave institucioneve nuk ka marrë veprimet e nevojshme për adresim të rekomandimeve të dhëna nga auditori i brendshëm 2. Funksionalizimi i njësive të auditimit në të gjitha subjektet e sektorit publik. 3. Ngritja e kapaciteteve dhe mbajtja e trajnimeve për auditorët e brendshmen, njësitë e auditimit dhe komitetet e auditimit nga Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB). 4. Përmirësimi i procesit të planifikimit strategjik dhe vjetor i auditimit të brendshëm, i bazuar në rrezik nga ana e njësive të auditimit të brendshëm (NJAB). 5. Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve, për të vërtetuar se a janë marrë masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve në afatet e parapara nga NJAB. 6. Në raportin e radhës së NJQHAB-së, të bëhet saktësimin i institucionit që nuk kanë bërë adresimin e rekomandimeve të dhëna. 7. NJQHAB të vazhdojë me skemën e certifikimit të auditorëve të brendshëm në sektorin publik. 8. Raportit vjetor për funksionimin e kontrollit të brendshëm të financave publike në

sektorin publik, t'i bashkëngjitet formulari i vetëvlerësimit për vitin 2017, në afatin kohor kur të dorëzohet raporti. Me këtë u mbyll diskutimi për këtë pikë me këtë

Përfundim:

KMFP, miratoi Raportin vjetor për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2016, së bashku me rekomandimet dhe të njëjtin ta adresojë për në seancë plenare për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017

Kryetari paraqiti para deputetëve planin e punës së KMFP-së për muajin tetor-dhjetor 2017, mirëpo shumica e aktiviteteve të paraqitura në këtë raport janë të shqyrtuara në komision, për shkak të shqyrtimit të vonshëm të këtij plani. Po ashtu, njoftoi se në fund të muajit nëntor 2017, parashihet sipas Strategjisë Legjislative të Qeverisë, që të vijë në Kuvend edhe Projektligji për kontrollin e brendshëm të financave publike. Meqenëse nuk pati ndonjë plotësim nga anëtarët, komisioni nxori këtë

Përfundim:

KMFP, miratoi planin e punës së komisionit për pjesën e mbetur të vitit 2017, në formën e dorëzuar nga administrata e komisionit.

5. Të ndryshme

Kryetari njoftoi deputetët se në komision, në pritje për shqyrtim, është edhe raporti i performancës së ZKA-së për vitin 2016 dhe propozoi që në mbledhjen e radhës të diskutohet për këtë raport. Po ashtu, njoftoi deputetët së ZKA ka dorëzuar planin e auditimit për sezonin e ri të auditimit dhe shtoi se është mirë që, nëse keni vërejtje në planin e auditimit për sezonin e ri të auditimit apo keni propozime për auditime shpesh, t'i bëni tani. Një propozim tjetër ishte që të kërkohet nga auditori i përgjithshëm që të përgatisë një listë me institucionet, të cilat janë audituar për vitin 2016, për të cilat raportet e auditimit të tyre kanë pasur opinione jo të mira. Më pastaj, më 16 nëntor 2017, do të jetë për vizitë në komision auditori i përgjithshëm i Polonisë. Takimi do të mbahet në orën 11.00, në Kuvend.

Faton Topalli, tha se është mirë që ZKA të na dërgojë një listë të institucioneve të audituara për vitin 2016, e që sipas auditorit, është mirë që të shqyrtohen në komision, më pastaj komisioni në mbledhjen e radhës do të vendosë se cilat nga këto raporte do t'i shqyrtojë.

Zafir Berisha, theksoi se për auditimet e radhës është mirë që Zyra Kombëtare e Auditimit të bëjë auditim të KEDS-it.

Shqipe Pantina, propozoi që Zyra Kombëtare e Auditimit të bëjë auditim të performancës për RTK-në.

Kryetari, pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar për këtë pikë të rendit të ditës, konstatoi këtë

Përfundim:

KMFP, vendosi që në mbledhjen e radhës së komisionit, ta shqyrtojë raportin e performancës së Zyrës së Kombëtare të Auditimit, së bashku me PVF-të e auditura për vitin 2016. Për të prezantuar raportin në komision, të ftohet auditori i përgjithshëm.

Me kaq e konsideroi këtë takim të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj